

Mësim praktik (Metoda katër - shkallëshe) I

Shembull i mësimin praktik në një punëtori automjetesh

Tema: Ndërrimi i gomës së paramontuar në një automjet

Qëllimet e ushtrimit praktik:

Psikomotorik: Nxënësi duhet të jetë në gjendje të bëjë ndërrimin e gomës në automjet

Kognitiv: Nxënësi duhet të jetë në gjendje të përshkruaj dhe sqarojë veprimet e nevojshme si dhe ti ketë të njohura masat e sigurisë

Affektiv: Duhet ti pranojë masat e sigurisë

Nxënësi: Në vitin e parë shkollor

Metoda e shkollimit: Metoda katër-shkallëshe

Mjetet e punës: Objektet dhe veglat e punës

Kontrolli i planifikuar i qëllimit të mësimin: Hapat e punës të shprehen në fjalë (verbalizim)
Të përcjellurit e imitimit dhe ushtrimit nga ana e mësimdhënësit (instrukturit)

Shkalla	Hapat dhe përmbajtja e mësimin	Vërejtjet	Koha
1. Përgatitja e parë	Mësimdhënësi parapërgatitë gjendjen e shkollimit: - Ai kërkon porosi të përshtatshme të ndonjë klienti - Ai përkujdeset për një zhvillim pa pengesa në punëtori	Parimi i sistematikës Parimi i afërsisë praktike	
	Mësimdhënësi përgatitë nxënësin për: - I flet për rëndësinë e pajisjes me goma korrekte, - I emërtun qëllimet e mësimin dhe i lejon atij ti përsërisë	Prej të përgjithshmes kah e veçanta Orientim kah qëllimi i mësimin Parimi i aktivizimit	2'
	Mësimdhënësi përcakton para njohuritë e nxënësit: - Vrojtimi i gadishmërisë së objektit mësimor? - Të lejojë raportimin, kujdes - gabimet Më vonë, gjatë zbatimit, të bisedohet lidhur me to	Prej të njohurës kah e panjohura	2'
	Mësimdhënësi zgjon interesimin e nxënësit duke i përmendur mundësinë e ndërrimit të gomës në automjetin e tij familjar.	Krijimi i tronditjes Theksimi i aspekteve të dobishme	
	Mësimdhënësi zgjon vetëdijen e përgjegjësive së nxënësit lidhur me sigurinë e klientit, përdoruesit të automjetit.	Nxitja e përgjegjësive personale	
	Mësimdhënësi lejon emërtimin e veglave të duhura të punës nga ana e nxënësit dhe e lut atë që këto vegla ti sigurojë për vehte.	Parimi i punës së pavarur	